



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1532/5 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

**VENDIM**  
**Nr.248, datë 29.12.2017**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 111, DATË 28.04.2017,**  
**NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT DIBËR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 111, datë 28.04.2017 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër,

**KONSTATOVA SE:**

Me vendimin Nr. 139, datë 30.12.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 111, datë 28.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Për të rregulluar situatën në lidhje me pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit të qarkut, me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të Vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky proces duhet të gjejë pasqyrim edhe në përshkrimin e punës për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit.
3. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër, si akte të dala në kundërshtim me ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil.

*Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:*

- ✓ *Anulimin e aktit nr. 2148/8, datë 15.08.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit” për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është deklaruar “Nëpunësi civil”;*
- ✓ *Anulimin e aktit nr. 2148/12, datë 15.08.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, për punonjësen \*\*\*\*\*, me të cilin është deklaruar “Nëpunësi civil”;*

✓ *Anulimin e pjesshëm të aktit nr. 2148/13, datë 15.08.2014, “Verifikim i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktualë”, për pjesën në të cilën refuzohet deklarimi i statusit të punësimit për punonjës* \*\*\*\*\*.

4. *Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si organizma që menaxhojnë burimet njerëzore të institucionit, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.*

*Në ndarjen “Kërkesat e posaçme”, të plotësohen në mënyrë të qartë kërkesat e posaçme që duhet të plotësojë nëpunësi për: nivelin e arsimit (niveli i diplomës “Bachelor”; “Master Profesional”; “Master i Shkencave” që ai/ajo duhet të zotërojë); profili i arsimit të lartë që duhet të ketë; kualifikimet/trajnimet dhe kërkesa të tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës të shërbimit civil.*

*Institucioni i mbikëqyrur t’i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të Vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.*

*Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), përshkrimet e punës t’i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të Vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.*

*Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.*

5. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër, në respektim të nenit 62, të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit Nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, të kryejë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2016, për punonjësen \*\*\*\*\*, e cila në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë e emëruar në pozicionin Specialist (Jurist), në Sektorin Juridik.

Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për këtë nëpunëse, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të Kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.

6. Prefekti i Qarkut Dibër të anulojë aktin nr. 11, datë 09.06.2016, me të cilin punonjësi \*\*\*\*\* është konfirmuar “nëpunës civil”, në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Auditit”, si akt i nxjerrë në kundërshtim të hapur me ligjin. Njësia e burimeve njerëzore të kujdeset që të përmbushen të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji dhe aktet nënligjore në lidhje me përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të përcaktimeve të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, finalizimi i procesit të konfirmimit të këtij punonjësi duhet të bëhet pasi të përfundojë me sukses trajnimin e detyrueshëm në Shkollën e Administratës Publike (ASPA) dhe të vlerësohet pozitivisht për punën e kryer.

7. Titullari i institucionit të nxjerrë aktin individual të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për punonjësin \*\*\*\*\*, i cili në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka qenë i emëruar në pozicionin “Specialist i Auditit të Brendshëm”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër dhe për të cilin DAP ka refuzuar të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për këtë punonjës me arsyetimin se ai nuk i plotëson kriteret për të qenë nëpunës civil.
8. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit të sistemojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato që janë deklaruar me mangësi në anekset përkatëse, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 111, datë 28.04.2017, të Komisionerit, me Vendimin Nr.177, datë 27.07.2017, “Për verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit nr. 111, datë 28.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, i cili në datën 06.09.2017, u paraqit pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1532/3 prot., datë 30.06.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt, komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe vendimin paralajmërues të Komisionerit (*pika 2 e tij*), objekt i këtij verifikimi, është kërkuar nga njësia përgjegjëse (DAP), që të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm” në institucionin e Prefektit të Qarkut, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të Vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Siç rezultoi nga aktet e administruara në dosjen e verifikimit, në zbatim të pikës 2 të rekomandimit të vendimit të Komisionerit, me shkresën nr. 1352, datë 28.04.2017, Prefekti i Qarkut Dibër, i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike interpretim në lidhje me kategorinë dhe klasifikimin e pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm në skemën e administrimit të shërbimit civil. Nga ana tjetër, Departamenti i Administratës Publike nuk është shprehur ende në lidhje me këtë çështje.

**Në pikën 3 të vendimit** paralajmërues të Komisionerit, i është kërkuar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, që në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi pozicionet e punës në zyrën e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, Prefekti i Qarkut Dibër në zbatim të rekomandimit të kësaj pike të vendimit të Komisionerit, me shkresën nr. 1353, datë 24.08.2017, i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike anulimin e akteve të deklarimit të statusit të punësimit.

Në përfundim të verifikimit në subjekt rezultoi se Departamenti i Administratës Publike nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e kësaj pike të vendimit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, **në pikën 4 të vendimit**, i ka kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, si dhe Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës sipas përcaktimeve të pikës 19, të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar dhe në ndarjen “Kërkesat e posaçme”, të plotësohen në mënyrë të qartë kërkesat e posaçme që duhet të plotësojë nëpunësi.

Gjatë verifikimit në subjekt rezultoi se me shkresën nr. 1336, datë 23.08.2017, Prefekti i Qarkut Dibër i ka dërguar Departamentit të Administratës Publike formularët e përshkrimit të punës për konfirmimin e ligjshmërisë së tyre, por nga ana e DAP nuk është kthyer ende përgjigje.

Nga ana e grupit të punës u konstatua se formularët e përshkrimeve të punës ishin hartuar sipas përcaktimeve ligjore të cituara më sipër dhe në përputhje me rekomandimin e Komisionerit (një kopje e formularit të përshkrimit të punës është administruar në dosjen e verifikimit të zbatimit të vendimit).

**Në zbatim të pikës 5 të vendimit** paralajmërues të Komisionerit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër, ka kryer procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2016, për punonjësen \*\*\*\*\*, e cila në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë e emëruar në pozicionin

Specialist (*Jurist*), në Sektorin Juridik. Gjatë kësaj procedure, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka respektuar kërkesat e përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar (*formulari i vlerësimit është administruar nga ana e grupit të punës*).

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil **në pikën 6 të vendimit** ka kërkuar nga Prefekti i Qarkut Dibër dhe njësia e burimeve njerëzore anulimin e aktit nr. 11, datë 09.06.2016, me të cilin punonjësi \*\*\*\*\* është konfirmuar “nëpunës civil” në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Auditit”, për shkak se punonjësi nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në nenin 67, pika 3 e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (*ishte i punësuar për një periudhë më pak se një vit*) dhe duhej deklaruar “nëpunës civil në periudhë prove”.

Nga verifikimi në subjekt rezultoi se akti nr. 11, datë 09.06.2016, nuk është anuluar nga ana e institucionit, megjithatë njësia e burimeve njerëzore të Prefektit të Qarkut Dibër ka respektuar të gjitha procedurat e parashikuara në nenin 24 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht, njësia e burimeve njerëzore ka mundur kryerjen e ciklit të detyrueshëm të trajnimit për punonjësin \*\*\*\*\* pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për periudhën 13-24 Shkurt 2017, në përfundim të të cilit ai është vlerësuar me 21 pikë nga 28 të mundshme. Punonjësi i ka kryer detyrat nën kujdesin e një nëpunësi të vjetër civil, i cili, në përfundim të periudhës së provës, me shkresën nr. 444/1, datë 08.03.2017, ka paraqitur mendimin e tij me shkrim, në përputhje me parashikimin e pikës 7 të Kreut VI të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Me Vendimin nr. 02, datë 19.05.2017, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, në cilësinë e eprorit direkt, pasi ka konstatuar zbatimin e gjithë procedurës së përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka vendosur konfirmimin e punonjësit \*\*\*\*\*, “Nëpunës civil” në pozicionin “Përgjegjës Sektori” në Administratën e Prefektit të Qarkut Dibër.

Vendimi i mësipërm i është njoftuar Departamentit të Administratës Publike me shkresën nr. 807, datë 22.05.2017, të titullarit të institucionit. Gjatë verifikimit në subjekt rezultoi se nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer ende përgjigje për këtë rast (*praktika e plotë e këtij rasti është administruar në dosjen e verifikimit*).

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, **në pikën 7 të vendimit**, ka kërkuar nga ana e titullarit të institucionit të nxjerrë aktin individual të ndërprerjes së marrëdhënieve të

punës për punonjës in \*\*\*\*\*; i cili në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka qenë i emëruar në pozicionin “Specialist i Auditit të Brendshëm”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër dhe për të cilin DAP ka refuzuar të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit me arsyetimin se ai nuk i plotëson kriteret e posaçme për këtë pozicion pune.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të punës, rezultoi se nga ana e titullarit të institucionit nuk ishte nxjerrë asnjë akt për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës në pozicionin “Specialist i Auditit të Brendshëm”. Në momentin e verifikimit punonjësi L. Ismaili rezultoi se ishte transferuar në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”. Për këtë arsye, grupi i verifikimit, kërkoi nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të gjithë praktikën e procesit të transferimit për këtë punonjës, nga ku rezultoi se:

Me shkresën nr. 23/7, datë 04.02.2016, Komisioni i Ristrukturimit, ka propozuar transferimin e punonjësit në fjalë, nga pozicioni “Specialist në Sektorin e Auditit”, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”.

Me aktin nr. 1352/4, datë 06.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, ka vendosur transferimin e punonjësit Lami Ismaili në detyrën “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”.

Në kushtet kur punonjësi \*\*\*\*\*; i emëruar në pozicionin “Specialist i Auditit të Brendshëm”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër, nuk i plotëson kriteret e posaçme për këtë pozicion pune dhe për këtë arsye është kërkuar ndërprerja e marrëdhënies së punësimit me shërbimin civil, Departamenti i Administratës Publike nuk mund të vendoste transferimin e përhershëm të këtij punonjësi për shkak të ristrukturimit në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”. Instituti i transferimit përdoret ekskluzivisht për nëpunësit civilë, referuar neneve 49 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe në këtë rast, punonjësi në fjalë nuk mund të konsiderohet si i tillë për arsyet e shpjeguara më sipër. Prandaj DAP, me të drejtë ka refuzuar të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për këtë punonjës. Sa më sipër, akti i transferimit nr. 1352/4, datë 06.04.2016, është në kundërshtim me ligjin material, e për rrjedhojë ai është një akt i paligjshëm. Departamenti i



Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër, bazuar në nenin 114, pika 1 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të vendosë shfuqizimin e këtij akti dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për punonjësin Lami Ismaili.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në zbatim të rekomandimit të pikës 8 të vendimit të Komisionerit ka sistemuar dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato që ishin deklaruar me mangësi (dosjet ishin plotësuar me dëshmi penalteti si dhe raporte mjekësore dhe çdo dosje kishte inventarin përkatës të dokumenteve që përmbante).

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 111, datë 28.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues. Aktualisht, pritet reagimi i Departamentit të Administratës Publike në lidhje me:

1. Kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit të qarkut ose pozicionin e barasvlershëm me të, detyrë e lënë në pikën 2 të vendimit të Komisionerit.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit nr. 2148/8, datë 15.08.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit” të punonjësit \*\*\*\*\*, me detyrë Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile”; aktin nr. 2148/12, datë 15.08.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, të punonjësës \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile” dhe aktin nr. 2148/13, datë 15.08.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit” të punonjësit \*\*\*\*\*, me detyrë Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile” në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër.
3. Konfirmimin nëse përkrahjet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, përcaktuar në pikën 4 të vendimit.
4. Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 1352/4, datë 06.04.2016 të Departamentit të Administratës Publike “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, të punonjësit Lami Ismaili në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të

*Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara*, në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil për këtë punonjës.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 111, datë 28.04.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Dibër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 3, 4 dhe 7 të dispozitivit të Vendimit Nr. 111, datë 28.04.2017, për të cilat kërkohet reagimi i Njësisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**